



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 161

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 19 shtator 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 562, datë 18.9.2024	Për lirim nga detyra..... 19207
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 563, datë 18.9.2024	Për lirim nga detyra..... 19207
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 564, datë 18.9.2024	Për lirim dhe emërim në detyrë..... 19207
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 565, datë 18.9.2024	Për emërim në detyrë..... 19207
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 566, datë 18.9.2024	Për emërim në detyrë..... 19207
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 567, datë 18.9.2024	Për emërim në detyrë..... 19208
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 568, datë 18.9.2024	Për emërim në detyrë..... 19208
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 18.9.2024	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 365, datë 16.6.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve dhe punonjësve të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare”..... 19208
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 582, datë 18.9.2024	Për indeksimin e pensioneve..... 19209

**VENDIM****Nr. 562, datë 18.9.2024****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Almira Xhembulla, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 563, datë 18.9.2024****PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Vilma Bello, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 564, datë 18.9.2024****PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Endrit Yzeiraj, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, lirohet nga kjo detyrë dhe emërohet zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 565, datë 18.9.2024****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Sofjan Jaupaj emërohet zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 566, datë 18.9.2024****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Ilva Gjuzi emërohet zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 567, datë 18.9.2024****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Silda Çepe emërohet zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 568, datë 18.9.2024****PËR EMËRIM NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Blerta Rama emërohet zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM**Nr. 578, datë 18.9.2024****PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË
VENDIMIN NR. 365, DATË 16.6.2023, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE TË
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE
QEVERITARE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 10, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 365, datë 16.6.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve dhe punonjësve të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare”, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Lidhja nr. 2, e përmendur në pikën 4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) Funksionet “Specialist arkivi” dhe “Specialist protokolli” përfitojnë një shtesë mbi pagë, për kushte pune (natyrë të veçantë pune), në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2024, përballohen nga të ardhurat e institucionit.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.9.2024.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LIDHJA NR. 2

STRUKTURA E PAGËS SË PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË DREJTORISË SË SHËRBIMEVE QEVERTARE

Funksioni	Kategoria/klasa	Shtesa për vjetërsi (%)	Shtesa për kushte pune (lekë)
Kryekuzhinier kategoria 1	IX	1%	135,000
Kryekuzhinier kategoria 2	IX	1%	75,000
Kryepastiçier	IX	1%	50,000
Kryekamerier	IX	1%	45,000
Administrues Vila 4, Vila 30	IX	1%	70,000
Administrues vila/qendrash	IX	1%	35,000
Ndihmëspastiçier	VIII	1%	35,000
Banakier	VIII	1%	42,500
Kryepunëtor Rezidenca Qeveritare	VIII	1%	35,000
Magazhinier i magazinës qendrore; industriale; Parku Delegacioneve; ushqimore; Pallati i Brigadave	VIII	1%	20,000
Magazhinier i magazinës dytësore Pallati Kongreseve; rekupero; dytësore Durrës;	VII	1%	20,000
Kuzhinier Rezidenca e Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit; Presidentit	VII	1%	35,000
Kuzhinier Vila Qeveritare	VII	1%	35,000
Teknik elektrikist/hidraulik/mirëmbajtje/ operator shumëfishimi në kryeministri, punëtor në rezidenca qeveritare	VII	1%	35,000
Kamerier	VII	1%	40,000
Shofer/korrier; shofer në Kryeministri	VII	1%	45,000
Teknik të ndryshëm; teknik dispeçer	VII	1%	30,000
Teknik/kameraman, teknik/fotograf	VII	1%	80,000
Shofer	VI	1%	40,000
Punëtorë mirëmbajtjeje; punëtor gjelbërimi; roje magazina industriale; roje Pallati i Kongreseve, lavazhier,	IV	1%	20,000
Punëtor pastrimi, punëtor pastrimi në Kryeministri , punëtor lavanderie; roje/receptionist në Kryeministri	IV	1%	35,000

VENDIM

Nr. 582, datë 18.9.2024

PËR INDEKSIMIN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 61 e 88, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 17, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar; të nenit 24, të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të

Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 8, të ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”, të ndryshuar; të nenit 5, të ligjit nr. 9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar; të nenit 8, të ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e



punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”; të nenit 6/1, të ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar; të nenit 1, të ligjit nr. 8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar; të nenit 5, të ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetësve dhe palombarëve të forcave detare në pension”; të nenit 8, të ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar; të nenit 10, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”; të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 129/2021, “Për statusin ‘Fëmijë në përkujdesje të Republikës’”; si dhe të nenit 4, të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Indeksimin në masën 4.1 për qind të:

a) pensioneve të caktuara sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

b) pensioneve sociale, të caktuara në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

c) shtesës mujore, të përfituar me vendimin nr. 326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”;

ç) pensioneve të caktuara me dekretin nr. 758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”;

d) shtesës mbi pension, të dhënë sipas nenit 33, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet

shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

dh) shtesave mbi pension, të dhëna sipas neneve 38, 39 e 48, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 24, të ligjit nr. 4171, datë 13.6.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

e) pensioneve të caktuara dhe të rillogaritura me ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara me nenin 21 të këtij ligji;

ë) trajtimeve të veçanta financiare të familjeve të pilotëve fluturues, të caktuara sipas ligjeve nr. 8455, datë 4.2.1999, “Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve, që humbasin jetën në përmbushje të detyrës, gjatë fluturimit”, të ndryshuar, dhe nr. 9128, datë 29.7.2003, “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, të ndryshuar;

f) trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr. 9361, datë 24.3.2005, “Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë, lundrues të nëndetësve dhe palombarëve të forcave detare në pension”;

g) trajtimeve të veçanta financiare të punonjësve të minierave, të caktuara sipas ligjit nr. 8685, datë 9.11.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar;

gj) pensioneve të pleqërisë të punonjësve të minierave, të caktuara me ligjin nr. 150/2014, datë 6.11.2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”;

h) trajtimeve të veçanta financiare të caktuara sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

i) pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 10139, datë 15.5.2009, “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në



Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”;

j) pensioneve suplementare të caktuara sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar;

k) shpërblimit të caktuar sipas ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të ndryshuar;

l) pensioneve shtetërore të posaçme të caktuara në përputhje me nenin 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

ll) përfitimeve të caktuara sipas ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”;

m) trajtimeve të veçanta financiare sipas neneve 5/1/a dhe 5/1/b, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

n) trajtimit financiar, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 129/2021, “Për statusin ‘Fëmijë në përkujdesje të Republikës’”.

2. Indeksimin, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, e përfitojnë edhe pensionet që do të caktohen nga data 1.10.2024 e në vazhdim, me kusht që data e lindjes së të drejtës së pensionit të jetë deri në datën 30.9.2024, përfshirë edhe këtë datë.

3. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit, të caktuara sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me përjashtim të pensioneve të caktuara në përputhje me paragrafin e dytë, të nenit 96, të këtij ligji, si dhe pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr. 150/2014, që kanë datë fillimi të së drejtës deri më 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë, nga data 1.10.2024 e në vazhdim, nuk do të jenë më pak se 17 888 (shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë në muaj dhe më shumë se 35 776 (tridhjetë e pesë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë në muaj.

4. Pensionet e plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit, të caktuara në përputhje me ligjin nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e

anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, si dhe sipas paragrafit të dytë, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me datë fillimi deri më 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë, nga data 1.10.2024 e në vazhdim, nuk do të jenë më pak se 12 248 (dymbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e tetë) lekë në muaj, por jo më shumë se 17 888 (shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë në muaj.

5. Pensionet e parakohshme, të caktuara sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, të ndryshuar, me datë lindjeje të drejte nga data 1.10.2024 e në vazhdim, nuk do të jenë më pak se 17 888 (shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë në muaj.

6. Përfituesit e pensioneve, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”; nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”; si dhe nr. 150/2014, datë 6.11.2014, të caktuara me datë të fillimit të pensionit deri më 31.12.2014, përfshirë edhe këtë datë, përveç pensionit të indeksuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, do të vazhdojnë të përfitojnë edhe kompensimet për të ardhura mujore minimale në masën dhe në kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”; nr. 474, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, dhe nr. 17, datë 20.1.2007, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve të fshatit”, në atë masë që i kanë përfituar deri në datën 30.9.2024, përfshirë edhe këtë datë.

7. Kompensimet për të ardhura mujore minimale, në masën dhe në kriteret e përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 21.6.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensionistëve”; nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”; dhe nr. 474, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”, do t’i marrin edhe ata persona që do të përfitojnë pensione të parakohshme sipas ligjit nr.



10142, datë 15.5.2009, me datë lindjeje të drejte nga data 1.10.2024 e në vazhdim, me kusht që shuma e pensionit mujor të parakohshëm plus kompensimin e të ardhurave të jetë deri në 19 538 (nëntëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e tetë) lekë në muaj.

8. Përfituesit e pensioneve, sipas shkronjave “a”, “e” dhe “gj”, të pikës 1, të këtij vendimi, me datë fillimi të pensionit deri më 31.12.2014 dhe përfituesit e pensioneve të parakohshme, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, krahas pensionit dhe kompensimeve, sipas përcaktimeve në pikat 6 dhe 7, të këtij vendimi, do të marrin edhe kompensimet sipas masës dhe kriterëve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”, dhe nr. 471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”.

9. Përfituesit e pensionit familjar, përveç pensionit të caktuar sipas dispozitave të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, do të marrin edhe kompensimet për të ardhurat dhe për ndryshimin e çmimeve, sipas kriterëve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 763, datë 27.12.2006, “Për kompensimin e të ardhurave mujore të pensioneve”; nr. 415, datë 27.4.2009, “Për rritjen e pensioneve”; nr. 474, datë 30.6.2010, “Për rritjen e pensioneve”; nr. 138, datë 31.3.1994, “Për kompensimin e shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse”; nr. 471, datë 15.7.1996, “Për kompensimin nga ndryshimi i çmimit të bukës, vajgurit dhe gazit të lëngshëm”, dhe udhëzimeve në zbatim të tij, me kusht që pensioni që kishte apo që i takonte

mbajtësit të familjes të jetë llogaritur sipas dispozitave ligjore në fuqi deri më 31.12.2014.

10. Masa e pensionit të plotë social, duke filluar nga data 1.10.2024 e në vazhdim, do të jetë 9 710 (nëntë mijë e shtatëqind e dhjetë) lekë.

Shuma bazë e pensionit e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit nr. 32, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për personat që plotësojnë periudhën e sigurimit, sipas përcaktimeve të nenit 92, të këtij ligji, duke filluar nga data 1.10.2024 e në vazhdim, të jetë 9 710 (nëntë mijë e shtatëqind e dhjetë) lekë.

11. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përlllogariten në shumën 1 693 000 000 (një miliard e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre milionë) lekë, të cilat përballohen nga fondi për politikën e indeksimit të pensioneve, i parashikuar në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të vitit, të cilat ndahen:

a) 1 657 000 000 (një miliard e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë) lekë, për mbulimin e pagesave të përfitimeve;

b) 36 000 000 (tridhjetë e gjashtë milionë) lekë, për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare sh.a., dhe bankat e nivelit të dytë.

12. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.10.2024.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 48 lekë